



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:227570

Datë: 29.08.2024

Numri i dokumentit: 06099638

KF.nr.441/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik Nuli, dhe me procesmbajtësen Arlinda Hyseni, në kontestin tregtar administrativ, të paditësit “Lab-Oil” Sh.P.K, me seli në Graçanicë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat Sahit Bibaj dhe avokat Gafurr Elshani nga Prishtina, kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulim e vendimi, objekt kontesti – vlerësim tatimor, vlerë e kontestit 43,399.55 euro, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor të mbajtur në prani të përfaqësuesve të autorizuar të palës paditëse avokat Sahit Bibaj, avokat Gafurr Elshani dhe në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur, me datë 30.07.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET si e bazuar, kërkesëpadia e paditësit me “Lab-Oil” Sh.P.K, me seli në Graçanicë.
- II. ANULOHET vendimi nr.254/2021 të datës 08.09.2021, i Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës me seli në Prishtinë dhe lënda kthehet në RISHQYRTIM DHE RIVENDOSJE.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 11.10.2021, ka iniciuar kontestin tregtar administrativ kundër të paditurës Administratës Tatimore të Kosovës, me të cilën ka kërkuar që të aprovet padia dhe kërkesëpadia e paditësit, të prishen si të kundërligjshme vendimet e të paditurës, dhe atë raporti i kontrolles i datë 25.06.2021, dhe pika III e dispozitivit të vendimit të paditurës me nr.254/2021 të datës 08.09.2021, ashtu që paditëses të i njihet rimbursimi i tatimeve

për periudhën e vitit 2017, në lartësi prej 43,399.55 €, nga baza e eliminimit të tatimit të dyfishtë në pajtim me marrëveshjen në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë, dhe në pajtim me ligjet në fuqi dhe të anulohen si të kundërligjshëm ndëshkimet e shqiptuara në këto shuma. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor dhe në fjalën përfundimtare, përfaqësuesi i autorizuar i paditësit deklaroi se: mbesin pranë padisë dhe kërkesë padisë, shtojmë edhe më tej se lënda ka të bëjë me të njëjtën materie sikurse në rastin KF.nr.623/2023 por ndryshon periudha kontestuese dhe vlera. Ne propozojmë që edhe në këtë lëndë gjykata të veproj sipas praktikës së njëjtë ashtu siç ka vendosur në rastin si më lartë KF.nr.623/2023. I propozojmë gjykatës që në bazë të provave të administruara dhe sipas praktikës nga rasti KF.nr.623/2023 të I. Aprovojnë padinë e paditësit si të bazuar, II. Të anulohet pjesërisht vendimi kontestues 254/2021 i datës 08.09.2021 dhe atë sa i përket pikës III të diapozitivit të të njëjtit referuar shpenzimeve të interesit bankar dhe III. Lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura në këtë pjesë. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

E paditura, në përgjigje në padinë e datës 16.02.2024 i kundërshton në tërësi pretendimet e paraqitura në padi të paditësit si të pa bazuara në ligj dhe në fakte materiale, dhe vlerëson se vendimi kontestues i Divizionit të Ankesave është i drejtë dhe në harmoni të plot me legjislacionin tatimor të aplikueshëm në Republikën e Kosovës. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor përfaqësuesi i të paditurit edhe pse i ftuar në mënyrë të rregullt nuk ka prezantuar, ndërsa me parashtresën e datës 26.07.2024 e ka njoftuar gjykatën se nuk do të prezantoj në këtë seance duke kërkuar nga gjykata që të veproj në bazë të nenit 38 paragrafi 5 të LKA-se. Duke i propozuar gjykatës të refuzohet padia/kërkesëpadija e paditësit në tërësi si e pa bazuar, dhe të mbetet në fuqi vendimi i ATK-së nr.254/2021 i datës 08.09.2021. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor publik të datës 30.07.2024, ka administruar provat dhe atë: Ankesa e ushtruar në ATK e datës 23.07.2021, Çertifikata rezidencë pa numër dhe datë e vitit 2017, Vendimi 254/2021 e datës 08.09.2021, Raporti i Kontrollit i datës 25.06.2021, Përgjigja në padi, dhe Vendimi 478/2019 i datës 05.12.2019.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe

në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar administrativ, deklarimeve në padi, shkresat e lëndës, aktvendimi kontestues, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit gjyqësor, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese fakti se paditësi pas pranimit të Raportit të Kontrollit të datës 25.06.2021, ka ushtruar ankesë me datë 23.07.2021, pranë Departamentit të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës, e për të cilën ankesë, ATK me datë 08.09.2021 ka sjell vendimin nr.254/2021, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, më të cilën e ka e ka aprovuar pjesërisht ankesën, ka anuluar dhe ndryshuar njoftim rivlerësimit e tatimit shtesë për periudhën tatimore në TAK-ë 2017, ndërsa refuzohet pjesa tjetër e ankesës lidhur me qarkullimin shtesë, e kundër të cilit vendim paditësi me padinë e datës 11.10.2021, ka iniciuar këtë kontest tregtar administrativ.

Gjykata nga vendimi kontestues vëren se ai përmban të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, të metat e tilla konsistojnë në faktin se arsyetimi i vendimit kontestuese nuk përmban arsye mbi faktet vendimtare, të vlefshme për zgjidhjen e drejtë të çështjes administrative në shqyrtim, dhe një arsyetim i tillë për gjykatën është i mangët dhe i pa qartë dhe kontradiktor. Gjykata vlerëson se vendimi i atakuar përmban të meta të tilla për shkak të cilave nuk mund të shqyrtohet ligjshmëria e tij dhe atë lidhur me tatimin në burim për interes në vitin 2017, për shpenzimet e interesit jashtë vendit nga Banka Credins në Shqipëri, dhe si i tillë edhe nuk mund të ekzaminohet në këtë pjesë, e sidomos nëse nuk është konstatuar drejtë gjendja faktike andaj doemos edhe është dashur që vendimi i kontestuar të anulohet dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura.

Gjykata vlerëson se në këtë lëndë të kontestit tregtar - administrativ nuk ka mundur të vërtetohet saktë dhe në tërësi gjendja faktike, andaj edhe është vepruar komfor nenin 43 par 2, të LKA-së, ku thuhet se : *“Nëse gjykata konstaton se konflikti administrativ nuk mund të shqyrtohet në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative për shkak se në pikëpamje të fakteve të vërtetuara ekzistojnë kontradikta në akte, gjë që në pikat esenciale nuk janë vërtetuar plotësisht, e që nga faktet e vërtetuara është nxjerrë konkluzioni jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike, ose konstaton se në procedurën administrative nuk janë respektuar rregullat e procedurës, që do të kishin rëndësi për zgjidhjen e çështjes, gjykata do të anulojë me aktgjykim aktin e*

kontestuar administrativ. Në një rast të tillë, organi kompetent ka për detyrë të veprojë ashtu si është caktuar në aktgjykim dhe të nxjerrë akt të ri administrativ”.

Gjykata konstaton se vendimi i kontestuar, nuk përmban arsye mbi faktet vendimtare, të vlefshme për zgjidhjen e drejtë të çështjes në shqyrtim. E paditura duhet edhe një herë të rivlerësoj çështjen tatimit në burim për interes në vitin 2017, për shpenzimet e interesit jashtë vendit nga Banka Credins në Shqipëri.

Pra sipas vlerësimit të kësaj gjykate e paditura një konstatim të tillë do të duhej ta bazonte në prova dhe dëshmi konkrete dhe jo vetëm ti mjaftonte konstatimi abstrakt sikurse në arsyetim të vendimit kontestues, ku ka theksuar se tatimpaguesi është ngarkuar me tatim në burim për interes në vitin 2017, për shpenzimet e interesit jashtë vendit nga Banka Credins në Shqipëri vlerën 433,995.53 €, që janë pranuar me kontroll si shpenzime rrjedhëse, mirëpo për këto shpenzime është ngarkuar tatimpaguesi me tatim të mbajtur në burim në vlerë $433,995.53 \text{ €} \times 10\% = 43,399.55 \text{ €}$, gjegjësisht tatim të mbajtur në burim 43,399.55 €, dhe se arsyetimi i tillë i paqartë dhe kontradiktor lidhur çështjen e tatimit në burim për interes në vitin 2017, për shpenzimet e interesit jashtë vendit nga Banka Credins në Shqipëri, është i barasvlershëm me mungesë të arsyetimit e që paraqet shkelje në dëm të këtu paditësit, ku pa evitimin e të cilës nuk mund të procedohet tutje. Prandaj, Gjykata në rivendosje e obligon të paditurën që të deklarohet lidhur me çështjet e theksuara si më lartë, dhe pas vlerësimit të tyre veç e veç të marrë vendim të drejtë, dhe të bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

E paditura duhet të deklarohet edhe për zbatimin të marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për shmangien e tatimit të dyfishtë lidhur mbi tatimet mbi të ardhura, në raste të tilla identike apo të ngjashme, duke dhënë vlerësime krahasuese pse kjo marrëveshje në këtë rast nuk ka gjetë zbatim të duhur, ndryshe nga rastet e tjera.

Gjykata vendos për çështjen e kontestit tregtar administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, në vështrim të nenit 43, paragrafi 1, të LKA-se. Në bazë të këtij parimi, Gjykata e ka të pamundur të vendos në mënyrë meritore lidhur me këtë pjesë në këtë kontest tregtar administrativ për arsye se ekzistojnë të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, andaj e aprovon kërkesëpadinë e paditësit, dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje. Gjykata bazuar në autorizimet nga neni 43 par.2 të LKA-së e detyron

të paditurën, që në ri procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në arsyetim të këtij aktgjykimi. Vërejtjet e cekura janë te obligueshme për organin e paditur, edhe duke u bazuar në nenin 65, të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Bazuar në nenin 7 paragrafi 1 dhe 3 i Ligjit për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 parasheh se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë me të cilat konstatohen faktet e tilla, Gjykata nuk mund ta bazojë vendimin e vet në faktet dhe provat, lidhur me të cilat palëve nuk u është dhënë mundësia që të deklarohen.”* Nga këto dispozita gjykata konsideron se përdorimi i mjeteve dhe metodave të provuarit, nënkupton një detyrim për palët dhe respektimin e procedurave ligjore të përcaktuara me ligj.

Vendimi për shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 64, të LKA-së.

Nga sa u parashtrua më lartë, gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit nenit 46 par. 2, 4 dhe 5 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së parë / Departamenti Fiskal

KF.nr.441/22, datë 30.07.2024

Procesmbajtëse
Arlinda HYSENI

Gj y q t a r i,
Fisnik NULI

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.